



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.Anr.414/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët Hidajete Gashi Alaj, kryesuese, Ramush Bardiqi dhe Arsim Hamzaj, anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e Vegim Ymeri, kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Vitisë, nga radhët e Subjektit Politik Nisma Socialdemokrate, të paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me seli në Prishtinë, Nr.01/3093-2025, të datës 03.11.2025, për shpalljen e rezultateve përfundimtare për anëtarë të kuvendit komunal për Zgjedhjet Lokale të datës 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur, me datë 07.11.2025, merr këtë:

V E N D I M

HEDHET e pasafatshme ankesa ZL.Anr.414/2025, datë 06.11.2025, e parashtruar nga kandidati për anëtar të kuvendit komunal në Komunën e Vitisë, Vegim Ymeri nga radhët e Subjektit Politik Nisma Socialdemokrate të paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me seli në Prishtinë, Nr.01/3093-2025, të datës 03.11.2025, për shpalljen e rezultateve përfundimtare për anëtarë të kuvendit komunal për Zgjedhjet Lokale të datës 12 Tetor 2025.

A r s y e t i m

Me datën 06.11.2025, PZAP-i ka pranuar ankesën e dërguar me postë me datë 04.11.2025, të kandidatit për anëtar të kuvendit komunal në Komunën e Vitisë, Vegim Ymeri, nga radhët e Subjektit Politik Nisma Socialdemokrate, me të cilën pretendon se kandidati Elham Emerllahu nuk i plotëson kushtet ligjore për certifikim, pasi pretendon të ushtron detyrën në Kuvendin e Vitisë, duke qenë banor i përhershëm në Fushë Kosovës. Tutje shton se vendbanimin e ka verifikuar përmes dokumentacionit të Shërbimit të Gjendjes Civile në Viti, ku rezulton se Elham Emerllahu nuk ka vendbanim të përhershëm në Viti, por në adresën e tij Dardani, Modsol, OB-ABM2-HY-2 nr.30/900, Fushë Kosovës. Tutje ka shtuar se për faktin se nuk i ka përmbushur kushtet ligjore për certifikim, ka kërkuar nga PZAP ta de certifikoj kandidatin Elham Emerllahu dhe ta certifikoj parashtruesin e ankesës si kandidat fitues për kuvendin Komunal të Vitisë. Në ankese ka bashkangjitur listën e kandidatëve të zgjedhur për Komunën e Vitisë, fotografi të formularit për regjistrimin e vendbanimit, vërtetimin dhe faturën e tatimit ne pronë me numrin e tatimpaguesit dhe të faturës, listën e renditjes së kandidatëve pas përfundimit të zgjedhjeve, kopjen e letërnjoftimit.

Në përgjigjen në ankesë të Komisionin Qendror të Zgjedhjeve – KQZ, dorëzuar me datë 07.11.2025, ka theksuar se, Zyra për Regjistrim, Çertifikim dhe Kontroll Financiar të

Subjekteve Politike, njofton se kandidati Elham Emerllahu është certifikuar nga KQZ-ja me datë 21.08.2025, me nr.01/2225-2025, sipas rekomandimit të Zyrës. Në këtë vendim është certifikuar subjekti politik Nisma Socialdemokrate me të gjithë kandidatët e saj, përfshirë edhe kandidatin e lartcekur. Tutje kanë shtuar se sipas aplikimit në platformën online për certifikim, të dhënat e kandidateve lidhen automatikisht me të dhënat e regjistrimit civil. Platforma nuk lejon vendosjen manuale të komunës, andaj kandidatet certifikohen sipas komunës ku figurojnë si banorë në regjistrin civil. Në këtë rast Elham Emerllahu figuron si banor i Komunës së Vitisë, dhe rrjedhimisht është certifikuar si kandidat për Kuvend Komunal të Vitisë nga Nisma Socialdemokrate. Tutje në përgjigje theksohet se zyra ka vepruar në përputhje me Rregulloren Zgjedhore Nr.04/2024 Certifikimi i Subjekteve Politike dhe Kandidatëve të tyre, adresa e kandidatëve merret sipa të dhënave të regjistrimit civil. Gjithashtu në kuadër të periudhës së kundërshtimit dhe konfirmimit të listës së votuesve (3 korrik-31 gusht 2025), DSHV nga pala ankuese, nuk ka pranuar kërkesë për kundërshtim të listës së votuesve për komunën e Vitisë. Prandaj pala ankuese nëse ka pretenduar se kandidati Elham Emerllahu, gjendet ne Listën e votuesve të komunës së Vitisë, dhe sipas tij është banor i komunës së Fushë Kosovës, është dashur që pretendimet e tij ti paraqes gjate periudhës së kundërshtimit dhe konfirmimit të listës së votuesve dhe brenda afatit të përcaktuar për paraqitjen e ankesave

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa - PZAP, pas shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të lëndës konstaton se:

Ankesa është e pasafatshme.

Në këtë rast, PZAP nga shqyrtimi i shkresave të lëndës, ankesës se ankuesit, përgjigjen në ankesë të KQZ-së konstatohet se parashtruesi i ankesës ka dorëzuar ankesën përmes postës me datë 04.11.2025, të cilën PZAP-i e ka pranuar me datë 06.11.2025, ku ka pretenduar se kandidati Elham Emerllahu nuk i ka plotësuar kushtet ligjore për certifikim si anëtar për kuvend komunal në Viti, për faktin se i njëjti nuk ka vendbanim të përhershëm në Komunën e Vitisë, Paneli e hedhe si të pasafatshme.

Me dispozitën e nenit 119 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, është paraparë që: “Personi i cili ka interes ligjor në një çështje brenda juridiksionit të PZAP-së, ose të drejtat e të cilit janë shkelur për sa i përket procesit zgjedhor të rregulluar sipas këtij ligji ose rregullave zgjedhore, mund të parashtrojë ankesë në PZAP brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i mbylljes së qendrës së votimit dhe PZAP vendos për ankesën brenda nëntëdhjetë e gjashtë (96) orëve nga parashtrimi i saj”. Në rastin konkret meqenëse, mediat vendore të cilat kanë parashtruar ankesë, tani më janë akredituar, sipas vendimeve të KQZ-së,

Me dispozitën e nenit 13, paragrafi 3, nën paragrafi 3.2 i Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, parasheh që: “PZAP-i e hedhë ankesën kur vlerëson se ajo nuk është dorëzuar në afatin e paraparë ligjor.” Paneli konstaton se certifikimi i kandidatëve për anëtar të Kuvendit komunal të Vitisë, është bërë më datë 21.08.2025 me vendimin nr.01/2225-2025, me çka vërtetohet se ankesa e ankuesit nuk është paraqitur brenda afatit ligjor prej 48 orëve siç parashihet me nenin 13, paragrafi 3, nën paragrafi 3.2 i Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave.

Paneli, vlerëson se, ankesa e parashtruar nga kandidati për anëtar të Kuvendit Komunal në Komunën e Vitisë, Vegim Ymeri, nga radhët e subjektit politik Nisma Socialdemokrate, për shkak të certifikimit të kandidatëve për anëtar të Kuvendit Komunal, është parashtruar pas afatit ligjor të përcaktuara me dispozitat e lartë cekuar, andaj PZAP vendosi që ankesa e ankuesit të hedhet si e pasafatshme.

Nga arsyet e theksuara më lartë dhe duke u bazuar nën 119 paragrafi 1, nën 115 paragraf 1 i LZP-së, nën 13, paragrafi 2, nën 13 paragrafi 3 nën paragrafi 3.2 të Rregullës 01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

ZL.Anr.414/2025, datë 07.11.2025

Kryesues i Panelit
Hidajete Gashi Alaj



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nën 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

AA.nr.115/2025

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Faton Bajrami, kryetar, Delushe Halimi dhe Nenad Lazic, anëtarë, duke vendosur sipas ankesës së Vegim Ymeri, kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Vitisë, nga radhët e Subjektit Politik Nisma Socialdemokrate, për shkak të parregullsive në shpalljen e rezultateve përfundimtare për anëtarë të kuvendit komunal për Zgjedhjet Lokale të mbajtura më datë 12 Tetor 2025, të paraqitur kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), ZL.Anr.414/2025, të datës 07.11.2025, në seancën e mbajtur më datë 13.11.2025, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Vegim Ymeri, kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Vitisë, nga radhët e Subjektit Politik Nisma Socialdemokrate, e paraqitur kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, ZL.Anr.414/2025, të datës 07.11.2025.

A r s y e t i m

Me vendimin e Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa ZL.Anr.414/2025, të datës 07.11.2025, është vendosur: "HEDHET e pasafatshme ankesa ZL.Anr.414/2025, datë 06.11.2025, e parashtruar nga kandidati për anëtar të kuvendit komunal në Komunën e Vitisë, Vegim Ymeri nga radhët e Subjektit Politik Nisma Socialdemokrate të paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me seli në Prishtinë, Nr.01/3093-2025, të datës 03.11.2025, për shpalljen e rezultateve përfundimtare për anëtarë të kuvendit komunal për Zgjedhjet Lokale të datës 12 Tetor 2025".

Kundër vendimit të lartpërmendur, kandidati për anëtar të kuvendit komunal në Komunën e Vitisë, Vegim Ymeri nga radhët e Subjektit Politik Nisma Socialdemokrate, në afat të lejuar ligjor ka paraqitur ankesë në Gjykatën Supreme, me të cilën e konteston ligjshmërinë e tij, duke pretenduar se PZAP ka hedhur poshtë ankesën e tij në kundërshtim me Ligjin nr.02/L-121 për vendbanimin dhe vendqëndrimin, si dhe Udhëzimin Administrativ nr.03/2015 për procedurat e lajmërimit dhe verifikimit të vendbanimit dhe vendqëndrimit, duke propozuar që Gjykata



Supreme të aprovojë ankesën e anëtarit të kuvendit komunal në Komunën e Vitisë, nga radhët e Subjektit Politik Nisma Socialdemokrate Vegim Ymeri, të shfuqizoj vendimin e PZAP ZL.Anr.414/2025, të datës 07.11.2025, ashtu që të kthej lëndën në rishqyrtim në PZAP ose alternativisht të vendosë në themel të çështjes, duke e anuluar vendimin e PZAP, të de-certifikoj kandidatin fitues Elham Emerllahu, dhe ta certifikoj atë si kandidat fitues.

PZAP në përgjigje në ankesën e paraqitur të anëtarit të kuvendit komunal në Komunën e Vitisë, nga radhët e Subjektit Politik Nisma Socialdemokrate Vegim Ymeri, kundër vendimit të tij të lartpërmendur, i kontestoi në tërësi thëniet ankimore dhe propozoi që ankesa e Vegim Ymeri, anëtar për kuvend komunal në Komunën e Vitisë, nga radhët e Subjektit Politik Nisma Socialdemokrate të refuzohet si e pabazuar, ndërsa të vërtetohet vendimi i ankimuar i PZAP-së.

Gjykata Supreme e Kosovës e vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të kontestuar, në kuptim të pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë, dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave të lëndës, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar.

Me datën 06.11.2025, PZAP-i ka pranuar ankesën e dërguar me postë me datë 04.11.2025, të kandidatit për anëtar të kuvendit komunal në Komunën e Vitisë, Vegim Ymeri, nga radhët e Subjektit Politik Nisma Socialdemokrate, me të cilën pretendon se kandidati Elham Emerllahu nuk i plotëson kushtet ligjore për certifikim, pasi pretendon të ushtron detyrën në Kuvendin e Vitisë, duke qenë banor i përhershëm në Fushë Kosovës. Tutje shton se vendbanimin e ka verifikuar përmes dokumentacionit të Shërbimit të Gjendjes Civile në Viti, ku rezultoi se Elham Emerllahu nuk ka vendbanim të përhershëm në Viti, por në adresën e tij Dardani, Modsol, OB-ABM2-HY-2 nr.30/900, Fushë Kosovës. Tutje ka shtuar se për faktin se nuk i ka përmbushur kushtet ligjore për certifikim, ka kërkuar nga PZAP ta de-certifikoj kandidatin Elham Emerllahu dhe ta certifikoj parashtruesin e ankesës si kandidat fitues për kuvendin Komunal të Vitisë. Në ankesë ka bashkangjitur listën e kandidatëve të zgjedhur për Komunën e Vitisë, fotografi të formularit për regjistrimin e vendbanimit, vërtetimin dhe faturën e tatimit ne pronë me numrin e tatimpaguesit dhe të faturës, listën e renditjes së kandidatëve pas përfundimit të zgjedhjeve, kopjen e letërnjoftimit.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve KQZ, me përgjigjen në ankesë të dorëzuar më datë 07.11.2025, ka theksuar se, Zyra për Regjistrim, Çertifikim dhe Kontroll Financiar të Subjekteve Politike, njofton se kandidati Elham Emerllahu është certifikuar nga KQZ-ja me datë 21.08.2025, me nr.01/2225-2025, sipas rekomandimit të Zyrës. Në këtë vendim është certifikuar subjekti politik Nisma Socialdemokrate me të gjithë kandidatët e saj, përfshirë edhe kandidatin e lartcekur. Tutje kanë shtuar se sipas aplikimit në platformën online për certifikim, të dhënat e kandidateve lidhen automatikisht me të dhënat e regjistrimit civil. Platforma nuk lejon vendosjen manuale të komunës, andaj kandidatët certifikohen sipas komunës ku figurojnë si banorë në regjistrin civil. Në këtë rast Elham Emerllahu figuron si banor i Komunës së Vitisë, dhe rrjedhimisht është certifikuar si kandidat për Kuvend Komunal të Vitisë nga Nisma Socialdemokrate. Më tej në përgjigje theksohet se zyra ka vepruar në përputhje me Rregulloren Zgjedhore Nr.04/2024 Certifikimi i Subjekteve Politike dhe Kandidatëve të tyre, adresa e



kandidatëve merret sipas të dhënave të regjistrit civil. Gjithashtu në kuadër të periudhës së kundërshtimit dhe konfirmimit të listës së votuesve (3 korrik-31 gusht 2025), DSHV nga pala ankuese, nuk ka pranuar kërkesë për kundërshtim të listës së votuesve për komunën e Vitisë. Prandaj pala ankuese nëse ka pretenduar se kandidati Elham Emerllahu, gjendet ne Listën e votuesve të komunës së Vitisë, dhe sipas tij është banor i komunës së Fushë Kosovës, është dashur që pretendimet e tij ti paraqes gjate periudhës së kundërshtimit dhe konfirmimit të listës së votuesve dhe brenda afatit të përcaktuar për paraqitjen e ankesave.

Paneli nga shqyrtimi i shkresave të lëndës, ankesës së ankuesit, përgjigjen në ankesë të KQZ-së ka konstatuar se parashtuesi i ankesës ka dorëzuar ankesën përmes postës më datë 04.11.2025, të cilën PZAP-i e ka pranuar me datë 06.11.2025, ku ka pretenduar se kandidati Elham Emerllahu nuk i ka plotësuar kushtet ligjore për certifikim si anëtar për kuvend komunal në Viti, për faktin se i njëjti nuk ka vendbanim të përhershëm në Komunën e Vitisë, Paneli e hedhe si të pasafatshme. Me dispozitën e nenit 119 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, është paraparë që: "Personi i cili ka interes ligjor në një çështje brenda juridiksionit të PZAP-së, ose të drejtat e të cilit janë shkelur për sa i përket procesit zgjedhor të rregulluar sipas këtij ligji ose rregullave zgjedhore, mund të parashtrojë ankesë në PZAP brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i mbylljes së qendrës së votimit dhe PZAP vendos për ankesën brenda nëntëdhjetë e gjashtë (96) orëve nga parashtimi i saj". Ndërsa me nenin 13, paragrafi 3, nën paragrafi 3.2 i Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, është përcaktuar se: "PZAP-i e hedhë ankesën kur vlerëson se ajo nuk është dorëzuar në afatin e paraparë ligjor." Paneli ka theksuar se certifikimi i kandidatëve për anëtar të Kuvendit komunal të Vitisë, është bërë më datë 21.08.2025 me vendimin nr.01/2225-2025, me çka vërtetohet se ankesa e ankuesit nuk është paraqitur brenda afatit ligjor prej 48 orëve siç parashihet me nenin 13, paragrafi 3, nën paragrafi 3.2 i Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtimit dhe Vendosjes së Ankesave.

Paneli, në fund ka vlerësuar se, ankesa e parashtuar nga kandidati për anëtar të Kuvendit Komunal në Komunën e Vitisë, Vegim Ymeri, nga radhët e subjektit politik Nisma Socialdemokrate, për shkak të certifikimit të kandidatëve për anëtar të Kuvendit Komunal, është parashtuar pas afatit ligjor të përcaktuar me dispozitat e lartcekura, andaj PZAP vendosi që ankesa e ankuesit të hedhet si e pasafatshme.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga gjendja e tillë faktike dhe ligjore e çështjes, e pranon në tërësi si të drejtë dhe të bazuar qëndrimin juridik të PZAP-it, si në vendimin e tij, lidhur me hedhjen si të pasafatshme të ankesës së kandidatit për anëtar të kuvendit komunal në Komunën e Vitisë, nga radhët e Subjektit Politik Nisma Socialdemokrate, Vegim Ymeri, ndaj vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Nr.01/3093-2025, të datës 03.11.2025, për shpalljen e rezultateve përfundimtare për anëtarë të kuvendit komunal për Zgjedhjet Lokale të mbajtura më datë 12 Tetor 2025. Kjo gjykatë vlerëson se vendimi i PZAP është i drejtë, i kuptueshëm dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, nga vërtetohet se edhe e drejta materiale është zbatuar drejtë në kuptim të dispozitave ligjore të Ligjit për Zgjedhjet Lokale dhe Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës. Nga kjo rezulton se shkeljet e pretenduara lidhur me parregullsitë në shpalljen e rezultateve përfundimtare për



anëtarë të kuvendit komunal vlerësohen të pabazuara, pasi që ankesa e ankuesit në fjalë nuk ka mundur të trajtohet (e njëjta është hedhur), pasi që ka rezultuar se është paraqitë jashtë afatit ligjor.

Me nenin 119 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, është përcaktuar se: "Personi i cili ka interes ligjor në një çështje brenda juridiksionit të PZAP-së, ose të drejtat e të cilit janë shkelur për sa i përket procesit zgjedhor të rregulluar sipas këtij ligji ose rregullave zgjedhore, mund të parashtojë ankesë në PZAP brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i mbylljes së qendrës së votimit dhe PZAP vendos për ankesën brenda nëntëdhjetë e gjashtë (96) orëve nga parashtrimi i saj". Ndërsa me nenin 13, paragrafi 3, nën paragrafi 3.2 i Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, është përcaktuar se: "PZAP-i e hedhë ankesën kur vlerëson se ajo nuk është dorëzuar në afatin e paraparë ligjor". Gjykata Supreme e Kosovës, duke marrë për bazë dispozitat e lartcekura dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës e ka vlerësuar të drejtë vendimin e PZAP, me të cilin kandidatit për anëtar të Kuvendit Komunal në Komunën e Vitisë, Vegim Ymeri, nga radhët e subjektit politik Nisma Socialdemokrate i është hedhë ankesa si e pasafatshme, kjo pasi që parregullsitë për të cilat kandidati në fjalë pretendon lidhur me mosverifikimin e drejtë dhe në mënyrë ligjore për certifikimin e kandidatit Elham Emerllahu, respektivisht pretendimet se i njëjti nuk është banor i komunës në të cilën ka kandiduar, ka pasur të drejtë që ti atakoj ashtu siç është përcaktuar me nenin 27 paragraf 6 të LZP-së: "Ankesa e cilitdo subjekt politik ndaj vendimit të KQZ-së për refuzimin e certifikimit të listës së kandidatëve, parashtrohet në PZAP brenda afatit prej njëzet e katër (24) orë pune pas pranimit të vendimit. PZAP vendos për ankesën brenda dyzet e tetë (48) orëve nga pranimi i saj.

Nga shkresat e lëndës rezulton se ankuesit me vendimin e PZAP i është refuzuar ankesa e paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me seli në Prishtinë, Nr.01/3093-2025, të datës 03.11.2025, ndërsa në anën tjetër rezulton se certifikimi i kandidatëve për anëtar të Kuvendit Komunal të Vitisë, është bërë më datë 21.08.2025 me vendimin nr.01/2225-2025, që i bie se ankuesi nuk e ka paraqitë ankesën brenda afatit ligjor prej 24 orëve siç parashihet me dispozitat e lartcekura të LZP-së dhe Rregulloren Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave, andaj është vlerësuar se kandidatit në fjalë me të drejtë i është hedhë ankesa si e pasafatshme nga PZAP.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme pretendimet e ankuesit lidhur me ligjshmërinë e vendimit të PZAP janë të pabazuara, për faktin se vendimi i kontestuar është i qartë dhe i kuptueshëm nga rezulton se PZAP drejtë ka vendosur lidhur me hedhjen e ankesës. Nga përmbajtja e ankesës rezulton se ankesa kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me Nr.01/3093-2025, të datës 03.11.2025, është paraqitur pas afatit ligjor prej 48 orëve, andaj me të drejtë PZAP e ka hedhë poshtë ankesën si të pas afatshme bazuar në dispozitat e LZP-së dhe Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave, edhe pretendimet ankimore të kandidatit për anëtar të Kuvendit Komunal në Komunën e Vitisë nga radhët e subjektit politik Nisma Socialdemokrate, Vegim Ymeri, në këtë drejtim janë refuzuar si të pabazuara.



Nga theksimet si më lartë dhe në bazë të nenit 118 paragrafi 4 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

AA.nr.115/2025, datë 13.11.2025

Kryetari i kolegjit,

Faton Bajrami



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
AKTËSINË E KOPJËS E VËRTETON
TAČNOST OTPRAVKA POTVRDJUJE

Punëtori i autorizuar
Dyfishçeni radnik



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVA
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS/ SUDSKI SAVET KOSOVA/ KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
SEKRETARIATI I KËSHILLIT GJYQËSOR TË KOSOVËS

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

Sheji i shkresës
Oznaka spisa:

AA-115/2025

FLETËDËRGESE PËR DORËZIM PERSONAL DOSTAVNICA ZA LICNO DOSTAVLANJE

PZAP - PRISHTINE

1. Pasi marrësi, i cili me tentimin e parë të dorëzimit nuk u gjet në vendin e ku është dashtë të bëhet dorëzimi i sa pas lënjes së lajmërimit me shkrim që për shkak të dorëzimit të gjendet në kohën e caktuar në banesën apo në vendin e punës së tij, dorëzimi është bërë: anëtarit madhor të familjes së marrësit - kujdestarit të ndërtesës, fqijt, personit që punon po n'atë vend me marrësin.

1. Posto primilac, koji pri prvom pokusajo dostave nije zatecen na mestu gde se dostavljanje ima izvršiti ni posle ostavljenog pismenog obavestenja da radi dostavljanja bude u odredjeno vreme u svom stanu radnom mestu, dostava je izvršena; odraslom članu domaćin. Primaoca nastojniku zgrace susedu licu zaposlenom na istom radnom mestu primaocem

2. Pasi marrësi ose anëtar i familjes së tij e refuzon marrjen e shkresës, shkresa u la në banesë në vendin e punës së marrësit (duke e ngjitur në derën e banesës ose të lokalit ku gjendet në punë marrësi).

2. Posto primilac odnosno član njenog domaćinstva odbio prijem, pismo je dostavljeno u stanu - radnom mestu primaoca (pribieno na vratima stana odnosno prostorije gde primilac zaposlen)

Më _____ 201 _____ në ora _____
dana _____ u _____ cas.

Shkaku i refuzimit të marrjes _____
Razlog odbijanja prijmea _____

Nënshkrimi i dorëzuesit - potpis dostavljača

Emri i shkresës që dorëzohet:
Naslov pisma koja se dostavlja:

AKT67UKIM 13.11.2025

Numri i shtojcave: _____
broj priloga _____

Vërtetoi se mora shkresën e lartpërmendur
më (me fjalë)
Povrdujemo prijem gorenavegenog pisma
(i slovima)

17.11.2025

(Nënshkrimi i marrësit ose i atij që
e ka marrë aktin në vend të tij
Potpis primaoca ili lica koje je
pismeno primilo u zamenu)

Nënshkrimi i dorëzuesit - potpis dostavljača

(Të panevojshmeve bjeri vizë - nepotrebne precrtači)

Në rast se marrësi është analfabet ose nuk është në gjendje të nënshkruajë dorëzuesi, duke shkruar shkaktun ose marrësi nuk e ka vënë nënshkrimin e vet. Ako je primilac nepismen ili nije u stanju da se potpiše, potpisuje ga dostavljač, napomenom zasto primilac nije stavio svoj potpis.